



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA
KOMUNA E KA
OPSTINA K



04.04/19 Kaçanik
Numri
01 Nr. 060/01/8615/19



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së III (Tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 29 Mars 2019.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 29 Mars 2019, dhe atë:

1. Vendimi për Aprovimin e Planit Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) për 2019-2021 / Lënda: 01Nr. 07-104/02-8154/19;
2. Vendimi për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës, parcelat kadastrale; 00174-0 dhe 00175-0, Zona Kadastrale Doganaj, për ndërtimin e shkollës së Re "Ali Asllani" në f. Doganaj / Lënda: 01Nr. 104/02-8061/19;
3. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të parcelave kadastrale Nr. 00229-2 dhe 00229-4, ZK Doganaj, në pronësi të Naser Guri / Lënda: 01Nr. 06-350/01-3151/19;
4. Vendimi për formimin e komisionit të Ankesave për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 60/01-8052/19;
5. Vendimi për Aprovimin Raporti i Punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 060/01-8564/19;
6. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 060/01-8600/19;
7. Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të KK 01 Nr. 05-400/01-4632/19 të datës 27.02.2019- Për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti fiskal 2018, në buxhetin e komunës të vitit 2019 /Lënda: 01Nr. 400/01-9498/19.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01. Nr.07-104/02-8154/19
Kaçanik, 27.03.2019

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-016 -Për Eficiencën e Energjisë (Gazeta Zyrtare Nr. 6/22 Korrik 2011), të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-081 - Për Energjinë (Gazeta Zyrtare Nr. 13/Korrik 2016) të nenit 17 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të Udhëzimit Administrativ(QRK) Nr. 09/2017- Për Zyrat Komunale të Energjisë, të nenit 6.1. të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29 Mars 2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT PËR VITET, 2019-2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet, Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Komunën e Kaçanikut, më tekstin e mëtejme” Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE), 2019-2021.
2. Plani Komunal i Veprimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, i jep komunës një drejtim strategjik për kursimin e energjisë elektrike, ku përmes objektivave të paraqitura, synohet të bëhet zvogëlimi i energjisë, rritja e nivelit të rehatisë dhe ulja e shpenzimeve të energjisë në buxhetin e komunës, për ndërtesat administrative, arsimore dhe atyre shëndetësore etj. të paraqitura si në PKVEE për vitet 2019-2021.
3. Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE), 2019-2021, përmban Numër të protokollit: 01. Nr.07-104/02-8154/19, është i përmbledhur në gjithsej 44 Faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e Planit komunal: për eficiencë, do të kujdeset, Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike(përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kenan Merseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-8061/19
Kaçanik, 29.03.2019

Në bazë të nenit 12 lidhur me nenin 14, 17 dhe 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6 Lidhur me nenin 34.5 të Statutit të Komunës të datës 25.09.2008, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me, 29 Mars 2019, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT
TË RI SHKOLLOR NË F. DOGANAJ

1. Me këtë Vendim, caktohet Lokacioni për ndërtimin e shkollës së Re “Ali Asllani” në f. Doganaj.
2. Lokacioni për ndërtimin e shkollës si në pikën 1. të këtij Vendimi caktohet në Parcelën Kadastrale **Nr. 00174-0**, në sipërfaqe, **156m²** në vendin e quajtur, “Fusha e Mulës- Katun” dhe në Parcelën Kadastrale **Nr. 00175-0**, në sipërfaqe **5584m²**, në vendin e quajtur “Fusha e Mulës – Ara të Shpija” Zona Kadastrale Doganaj, pronë komunale, shfrytëzues, P.SH. Shtëpia e Shëndetit.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Certifikata me Numër të Lëndës: 941-18055/2019 e lëshuar me datë: 18.03.2019 si dhe Kopja e Planit i datës 18.03.2019, lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës Kaçanik.
4. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pronën e paluajtshme të e regjistroj në RDPP.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Kaçanikut dhe mekanizmat tjere relevantë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e regjistrimit të protokollit të MAPL si dhe 7 Ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesusi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SH. SHTËPIA E SHËNDETTIT

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 941-8055/2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 18.03.2019 - 08:17
Komuna / Opština / Municipality: Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office: Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbëmr/Emitri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licni broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Drzava državljanstva ili uknjženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhurnuar Ažurirano Updated
P.SH. SHTËPIA E SHËNDETTIT			/	KCID0905776	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhurnuar Ažurirano Updated
KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK		EMIN DURAKU	KAÇANIK	

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTRARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastrarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale katastrarska zona Cadastral zone	Lloji i njësitë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Kati/ Br./Sprat a/ Floor Spratova number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917026-00174-0	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	DOGANAJ / DOGANOVIĆ / DOGANAJ	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		FUSHA E MULËS- KATUN / FUSHA E MULËS- KATUN / FUSHA E MULËS- KATUN	156	Tokë Ndërtimore - Shërbj-Ndërtues - / Tokë Ndërtimore - Obor - / / Gradjevinsko zemljište - Kuca- Zgrada - / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - Back Yard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	
P-70917026-00175-0	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	DOGANAJ / DOGANOVIĆ / DOGANAJ	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		FUSHA MULJES ARA TE SHPIJA / FUSHA MULJES ARA TE SHPIJA / FUSHA MULJES ARA TE SHPIJA	5584	Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 4 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 4 Klase / / Agriculture - Arable - 4th Class Arable Land / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Doganaj

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70917026-00174-0	Parcelë / Parcela / Parcel	156,0
P-70917026-00175-0	Parcelë / Parcela / Parcel	5584,0
66 941-8854		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:793

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 18.03.2019

Koha/ Vreme/ Time: 08:18:05

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoui/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-351/01-3151/19
Kaçanik, 29.03.2019

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 6.2 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 351/01-3151/19 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcelave Kadastrale ; 00229-2 dhe 00229-4 me Kulturë, Arë e Klasës së 2-të (Dytë) në Zonën Kadastrale, Doganaj, në pronësi të Naser Guri, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29 Mars 2019, mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet në Parcelën Kadastrale **00229-2** në sipërfaqen, **496m²** dhe në Parcelën Kadastrale, **00229-4** në sipërfaqe, **300m²**, me Kultura Bujqësore, Arë e klasës së 2 (Dytë) e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me P- Nr. 70917026-00229-2 dhe P-Nr. 70917026-00229-4, Zona Kadastrale Doganaj, në pronësi të, Naser (Eshref) Guri sipas Numrit të Lëndës, 941-1438/2019 të datës 16.01.2016. destinohet në tokë ndërtimore.
3. Parcela Kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet “degradim i lumenjve” dhe “toka bujqësore”, ndërkaq me këtë Vendim i ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore dhe e njëjta bëhet pjesë përkatëse e PZHK.
4. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
5. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
06.Nr.350-01-3151/19
Kaçanik, 19.02.2019

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në nenin 10.5 pika a të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokën Bujqësore; në bazë të nenit 6 pika 6.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësor, lidhur me kërkesën 06.Nr.350-01-3151/19 për ndërrim destinimi të tokës bujqësore:

Propozon

Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal, që lidhur me kërkesën e z.Naser Guri nga Kaçaniku për ndërrim destinimi të tokave bujqësore (arë e klasës së II-të) në atë ndërtimore, të merr:

VENDIM PARAPRAK

Aprovohet kërkesa 06.Nr.350-01-3151/19 datës 08.11.2018 e parashtruar nga z.Naser Guri për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, në parcelën kadastrale 229-2 (496m²) dhe 229-4(300m²) e evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-Nr.70917026-00229-2 dhe P-Nr.70917026-00229-4 Zona Kadastrale Doganaj me pronar z. Naser Guri.

Arsyetim

Në drejtorinë e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka arritur kërkesa me numër 06.Nr.350-01-3151/19 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë (arë e klasës së II-të), në tokë ndërtimore.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet “degradimi i humbjeve” dhe “tokat bujqësore”.



Drejtoriu drejtorisë
Ukshin Çallaku

 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë	 KAÇANIKU
	Drejtorati / Njesia Urbanizmit, Kadaster dhe Mjedis	Data (dita / muaji / viti)

1 Informatat personale të parashtresit të kërkesës:

Emri dhe mbiemri NASER GURI	Lloji dhe numri i dokumentit identifikues L.NJ. 1004568857
Data e lindjes 16.01.2017 (dita / muaji / viti)	Adresa e vendbanimit Komandant Zefi 108 (numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar)
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil 049/248324
E-mail adresa bubearikomerc@yahoo.com	

Mos shkruani në

Pranuar nga:

Numri i protokollit
06.37061-3157/19

Vendimi: po

Nga:

Data:

2 Selektro llojin:

Kërkesë ☒

Ankesë ☐

3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:


KERKIM NGA DREJTORIA PER URBANIZEM DHE MUNICIPI DOKRIMIN E DESTAKMIT TE TOKE KUA BUJQESORE NE TE NQERTIMORE DHE ATE NGJISTJA KAD. NR. 229-2 DHE 229-4 229-2 S = 496 M² 229-4 S = 300 M². DE GJITE AKE E KL. 2 NE 2K-4 DOGAZI

PRONAR NASER (ESHRET) GURI NGA J. NIKI KAÇANIKU

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Une **NASER GURI** vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Emri i plotë i aplikuesit)


 (Nënshkrimi)

*** Ju lutemi të kërkonë nga zyrtarja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkëngjitura ***



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJDITIS DHE PLANIFIKIMIT HAPËSNOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : GURI NASER

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 941-1438/2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 16.01.2019 - 11:43
Komuna / Opština / Municipality: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA


Mbiemri/Emri i afatizmit (biznesi) Prezime/ Naziv poslovanja (biznis) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i tabait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personali biznesi Lëni broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësië apo regjistrimit Drzava državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
GURI	NASER	ESHREF	Mashkull / Male	1004568857	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostil adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Azurirano Updated
KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK		EMIN DURAKU 124	KAÇANIK	

SIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/ CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarëska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale katastarëska zona Cadastral zone	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronisë Tip imovine Property Type	Katë Katet Bc, Sprat Floor Sprat number	Vendi i quajtur Zemro imovine Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shifra e njësive aktuale/ Kultura- klasa Aktuelna Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronisë Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhu Azhu Lpda
P-70917026-00229-2	Kaçanak / Kačanik / Kačanik	DOGANAJ / DOGANOVIC DOGANAJ	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land / R		DOGANAJ-ARA E MADHE / DOGANAJ-ARA E MADHE / DOGANAJ-ARA E MADHE	496	Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 2 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 2 Klasë / / Agriculture - Arable - 2nd Class Arable Land / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dravina / single possessor	04.10.;
P-70917026-00229-4	Kaçanak / Kačanik / Kačanik	DOGANAJ / DOGANOVIC DOGANAJ	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land / R		DOGANAJ-ARA E MADHE / DOGANAJ-ARA E MADHE / DOGANAJ-ARA E MADHE	300	Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 2 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 2 Klasë / / Agriculture - Arable - 2nd Class Arable Land / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dravina / single possessor	19.12.;



Situacioni i Relievimit tek Vepra e marjes te Ura ne Ish.Doganaj
 per HC-3 NP " 2 Koriku " Soponice
 Vrejte:
 Kuotat e matura jane mbi gypet e cili eshte ekzekutu ne teren
 ---- Gypet e punuar



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Doganaj

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70917026-00229-2	Parcelë / Parcela / Parcel	496,0
P-70917026-00229-4	Parcelë / Parcela / Parcel	300,0

06-941-1439



Shkalla/Razmera/Scale: 1:401

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 16.01.2019

Koha/ Vreme/ Time: 11:45:30

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:



Antërvori/Usvojen/Aproven

Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

01 Nr. 060/01-8052/19
Kaçanik, 29.03.2019

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), në çështjen e Propozim Vendimit të Panelit Përzgjedhës për Zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara prej datës 15.03.2019 si dhe Ankesat kundër anëtarëve të propozuar nga Panelit Përzgjedhës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbajtur e mbajtur me 29 Mars 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për zgjedhjen e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, në përbërje prej 3 anëtarëve dhe atë: 2 anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga dy subjektet politike me të mëdha dhe 1 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, i cili caktohet nga Kryetari i Komunës, si vijon:

1. Lirije Shurdhani-Dema, anëtare, nga KK (PDK)
2. Adnan Reka, anëtar, nga KK (LVV)
3. Mirlinda Dema, anëtare, nga Ekzekutivi i Komunës.

2. Kryetari i Komisionit nga pika 1.1 e këtij Vendimi zgjidhet nga radhët e anëtarëve.

3. Komisioni i përcaktuar nga pika 1.1. ka për detyrë të shqyrtoj, Ankesat kundër përzgjedhjes së anëtarëve të propozuar nga Paneli Përzgjedhës për zgjedhjen e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut.

4. Komisioni është i obliguar që për procesin e zhvilluar lidhur me Ankesat e shqyrtuara, të dal me një Raport në formë të shkruar me rekomandime, i cili raport do të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës.

5. Komisioni i Ankesave nga pika 1 e këtij Vendimi, është ad hoc, vetëm për zgjedhjen e Ankesave për Zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e regjistrimit të protokollit të MAPL si dhe 7 Ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohet: Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



01-60/01-8052/19

Paneli për përzgjedhjen e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara të Komunës së Kaçanikut, në bazë të pikës 6 të Vendimit 01.Nr. 104/02-34370/18 të datës 30/10/2018, pas përfundimit procedurave përzgjedhëse të kandidateve të cilët kanë aplikuar nëpërmjet konkursit publik, iu drejtohet Kuvendit të Komunës me këtë:

PROPOZIM

Që në mbështetje të nenit 12.2 lidhur me nenin 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të nenit 31, 32 lidhur me nenin 39.3 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, pas përfundimit të procedurës përzgjedhëse, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur më datë __/__/2019, të merr këtë:

VENDIM

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME
AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E KAÇANIKUT TË THEMELUAR ME
VENDIMIN 01.NR. 104/02-34370/18 TË DATËS 30/10/2018**

1. Me këtë Vendim, zgjedhen e anëtarët e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut të themeluar me vendimin 01.nr. 104/02-34370/18 të datës 30/10/2018.
2. Komiteti Konsultativ nga pika 1. e këtij Vendimi, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare të cilët janë njohës të fushave përkatëse në këtë përbërje:
 - a. Mirlinda Spahija
 - b. Mensur Luma
 - c. Mirlinda Axhami-Hysa
 - d. Artan Mezraja
 - e. Brikena Raka
 - f. Fiknete Krasniqi
 - g. Antigona Axhami-Baftijaj
3. Kompetencat e këtij komiteti janë: Dhënia e propozim rregullorëve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të Kryetarit të Komunës, Komiteteve të Përhershme apo Kuvendit të Komunës në fushën përkatëse, paraqitjen e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës. Propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuar, propozime këto të cilat nuk janë obliguese për Kuvendin e Komunës, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.
4. Çështjet të tjera lidhur me komitetin konsultativ do të rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizmit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

5. Për punën që kryejnë anëtarët e komitetit konsultativ, do të kompensohen në proporcion me mëditjet e anëtarëve të komiteteve të përhershme (nga 50€ për një mbledhje) por jo më shumë se 6 mbledhje brenda një viti.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të Kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarët e përzgjedhur dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Kemal Mërseli

SHTOJCË: Informatë rreth përzgjedhjes

Paneli përzgjedhës me ftesën e Kryesuesit të Kuvendit z. Kemal Mërseli, ka mbajtur takimin e parë me ç'rast ka zgjedhur kryesues z. Festim Neziraj, si dhe në të njëjtën kohë ka vendosur për formën e konkursit dhe kushteve të cilat do të duhej të përmbusheshin nga kandidatët potencial. Në takimin e dytë të panelit përzgjedhës, është vendosur në mënyrë unanime të shkohet direkt në intervistë nga të gjithë aplikantët si dhe ka vendosur që formën e intervistës ta paraqes në mënyrën që secili nga anëtarët t'ju bëhet nga një pyetje e cila ishte e njëjtë për të gjithë kandidatët. Konkursi dhe njoftimet publike janë publikuar në web-faqen e Komunës.

Në këtë konkurs kishin aplikuar 17 kandidat, (12 vajza dhe 5 djem). Nga verifikimi i aplikacioneve si dhe dëshmime të prezantuara rreth përvojës së punës në lëminë e personave me aftësi të kufizuara, paneli përzgjedhës vlerësoi se të gjithë parimisht i plotësojnë kushtet që të vazhdohet me procedurën e intervistimit. Kandidatët ishin ftuar me kohë dhe 16 prej tyre kanë marrë pjesë në intervistë me gojë nga paneli përzgjedhës. Gjatë procesit të intervistimit gjithçka ka shkuar sipas rregullave të cilat paneli ka paraparë si dhe kandidatët ishin prezent në kohë.

Kandidatët për komitetin komunal për persona me aftësi të kufizuara, kanë paraqitur ide mjaft të mira konform pyetjeve të cilat u janë bërë sa i përket rolit të tyre të cilët i pret angazhimi potencial në këtë komitet, që në fakt e ka vështirësuar përzgjedhjen mes tyre. Megjithatë, paneli përzgjedhës është përkujdesur që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe t'i dërgoj në kuvend emrat më meritorë dhe ka bërë vlerësimin në bazë të pikëve si dhe në bazë të pjesëmarrjes gjinore të kandidatëve.

Andaj, bazuar në këto që thamë më lartë, ju ftojmë që ta votoni këtë përbërje të këtij komiteti, me shpresën që kontributi i tyre të vërehet dukshëm për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë tone.

Kryesuesi i panelit përzgjedhës

Festim Neziraj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-34370/18
Kaçanik, 30.10.2018

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 20108) të nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të nenit 31, 32 lidhur me nenin 39.3 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryesuesit të Kuvendit 01Nr. 104/02-34370/18 prej datës 19.10.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me datë, 30 Tetor 2018, mori këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFËSITË KUFIZUAR NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, MIRATOHI I Propozim Vendimi i Kryesuesit të Kuvendit 01Nr. 104/02-34370/18 i datës 19 Tetor 2018 -Për Themelimin e Komitetit Konsultativ për personat me afësi të kufizuar në Komunën e Kaçanikut.
2. Komiteti Konsultativ nga pikat 1 e këtij Vendimi do të përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, nga qytetarë dhe përfaqësues të Organizatave Joqeveritare të cilët janë njohës të fushave përkatëse.
3. Caktimi i anëtarëve të Komitetit të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet përmes shpalljes së Konkursit Publik, për mandat 4 vjeçare, me mundësi të përzgjedhjes edhe për një mandat, përcaktuar si në Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016.
4. Kuvendi i Komunës shpallë Konkursin dhe përcakton kriteret për konkurrim.
5. Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ, formon Panelin në përbërje:

1. Ahmet Luma,	anëtar nga Kuvendi;
2. Kallia Tafili,	anëtare nga Kuvendi;
3. Arlinda Rakoci- Rakaj,	anëtare nga Kuvendi;
4. Festim Seziri,	anëtar nga Ekzekutivi; dhe
5. Elmire Krasniqi,	anëtare nga Shoqëria Civile.

6. Paneli përzgjedhës nga pika 5 e këtij Vendimi, punon sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 Për Procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative dhe na propozon Kuvendit të Komunës Listën e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut, për miratim.
7. Kompetencat e Komiteteve Konsultative janë: Dhënia e propozim rregullorëve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të Kryetarit të Komunës, Komiteteve të Përhershme apo Kuvendit të Komunës në fushën përkatëse; raportime të përkrahjeve dhe mendimeve të qytetarëve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës, propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuar, propozime këto të cilat nuk janë obliguese për Kuvendin e Komunës, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.
8. Çështjet të tjera lidhur me Komitetin Konsultativ do të rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2016 - Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë.
9. Për punën që kryejnë anëtarët e komitetit konsultativ, do të kompensohen në proporcion me mëdijtë e anëtarëve të Komiteteve të përhershme(nga 50 € për një mbledhje), por jo më shumë se 6 mbledhje brenda një viti.
10. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.
11. Ky Vendim bën në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqytarës MAPL, si dhe 30 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarët e Panelit Përzgjedhës dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

01 Nr. 060/01-8564/19
Kaçanik, 29.03.2019

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Komitetit për Komunitete, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Mars 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR
KOMUNITETE PËR VITIN 2018

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 060/01-8564/19-, më tekstin e mëtejme: "Raporti i Punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2018" i hartuar nga Komiteti për Komunitete.
2. Raporti Vjetor si në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban aktivitetin e realizimit të detyrave nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Komunitete dhe nivelin e realizimit të tyre, për gjatë vitit 2018.
3. Raporti i Komitetit për Komunitete është i përmbledhur në gjithsej 18 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohet: Komiteti për Komunitete, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Këmal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

01 Nr. 060/01-8600/19
Kaçanik, 29.03.2019

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Komitetit për Shërbime Publike, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Mars 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME
PUBLIKE PËR VITIN 2018

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 060/01-8600/19-, më tekstin e mëtejme: "Raporti i Punës i Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2018" i hartuar nga Komiteti për Shërbime Publike.

2. Raporti Vjetor si në pikën 1, të këtij Vendimi, përmban aktivitetin e realizimit të detyrave nga fushë veprimtarisë që janë në kompetencë të Komitetit për Shërbime Publike si dhe nivelin e realizimit të tyre, për gjatë vitit 2018.

3. Raporti i Komitetit për Shërbime Publike është i përmbledhur në gjithsej 2 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohet: Komiteti për Shërbime Publike, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 400/01-9498/19
Kaçanik, 29.03.2019

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-133 (Gazeta Zyrtare Nr. 4/14 Shkurt 2019).- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 si dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, duke vepruar sipas Shkresës së MAPL 020-230/10 të datës 27.03.2019 për zbatimin e Raportit të Komisionit për përshtatshmërinë akteve të komunave pran Ministrisë së Financave, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 29 Mars 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01Nr.05-400/01-4632/19 I DATËS 27.02.2019- PËR BARTJEN E MJETEVE TË PASHPËNZUARA NGA VITI FISKAL 2018, NË BUXHETIN E KOMUNËS TË VITIT 2019

1. Me këtë Vendim bëhet Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.05-400/01-4632/19 të datës 27 Shkurt 2019 – Për Bartjen e mjeteve buxhetore të pashpenzuara nga viti fiskal 2018 , në buxhetin e Komunës 2019.
2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës nga pika 1. e këtij Vendimi, bëhet të pikat: 2 dhe 3, si vijon:
 - 2.1. Të pika 2. Shuma për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2018, **285.701.49 € shtohet për 3.29€** dhe shuma e përgjithshme bëhet **285.704.78 €** dhe me këtë shumë Buxheti i Komunës së Kaçanikut është në shumën totale **8,667.358.78 €**.
 - 2.2. Të pika 3 e Vendimit, ndryshohet shuma 285,701.49, zëvendësohet me shumën: 285,704,78€.
 - 2.3. Të pika 3.1. Shuma për Mallra dhe Shërbime ndryshohet nga **2,937.88€** në shumën **2,941.17 €**
3. Pikat dhe nënpikat tjera të Vendimit, mbesin të pandryshuara.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë) dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 05-400/01-4632/19
Kaçanik, 27.02.2019

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-133 (Gazeta Zyrtare Nr. 4/14 Shkurt 2019).- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 si dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë: 27 Shkurt 2019, mori këtë:

V E N D I M
PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE BUXHETORE TË PA SHPENZUARA
NGA VITI FISKAL 2018, NË BUXHETIN E KOMUNËS TË VITIT 2019

1. Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve të vetanake të paspenzuara nga viti fiskal 2018, në buxhetin e komunës të vitit 2019.
2. Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2019 në shumë, **8,381.634.00 €**, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2018, nga viti fiskal 2019 në shumë, **285.701.49 €**, do të arrijnë shumën e përgjithshme, **8,667.355.49 €**.
3. Mjetet e pa shpenzuara në shumë, **285.701.49 €**, barten si vijon:


3.1. Për Mallra dhe Shërbime shuma.....	2,937.88 €
3.2. Për Shpenzime Komunale shuma.....	4,500.00 €
3.3. Subvencione dhe Transferë shuma.....	4,273.56 € dhe
3.4. Investime Kapitale shuma.....	273,990.05 €
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Shtojcat A dhe B të pesë (05) pasqyrave tabelave e bilanceve të pa shpenzuara nga viti fiskal 2018 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2019 në Nën-programet përkatëse, kategoritë ekonomike dhe kodet e projekteve.
5. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim të njoftohen:

1. Kryetari i Komunës përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen shërbimet (jera)
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseti





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 22.03.2018

Nr.020-230/7

Për: Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut

Kemajl Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, Vendimin Nr. 05-400/01-4632/19 për bartjen e mjeteve vetanake buxhetore të pa shpenzuara nga viti fiskal 2018, në buxhetin e komunës të vitit 2019, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Kaçanikut, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 05.03.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Financave.

Bashkangjitur gjeni Raportin nga MF lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj

Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

*Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Arkivit të MAPL-së*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Financave - Ministarsvo za Finansije - Ministry of Finance

DATE/A:	19.03.2019
REFERENC-E:	45/ 2019
PËR/ZA/TO:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme të NAL-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Naim Bafiu, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
NGA/OD/FROM:	Komisioni për mbikëqyrjen e përshatshmërisë të akteve të Komunave: 1. Bahrije Berisha - Kryesuese; 2. Lumije Hetemi - Anëtare; 3. Jak Ndrecaj - Anëtar; 4. Imer Rudari - Anëtar; 5. Arta Vehapi - Anëtare.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i Vendimit Nr.05-400/01-4632/19 për hartjen e mjeteve vetanake buxhetore të pa shpenzuara nga viti fiskal 2018 në buxhetin e komunës të vitit 2019

F nderuara znj. Ukimeraj,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave dhe Vendimit Nr. 88/2016 të dt. 15.06.2016 Komisioni për Vlerësimin e Ligshmërisë së Akteve të Komunave, në shkresën e pranuar, me datë 14.03.2019 me Nr. Protokollit, 347 të Vendimit Nr.05-400/01-4632/19 për hartjen e mjeteve vetanake buxhetore të pa shpenzuara nga viti fiskal 2018 në buxhetin e komunës të vitit 2019, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut dhe nënshkruar nga Kryesuesi e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për vlerësim të ligshmërisë.

Komisioni pas vlerësimit të përshatshmërisë në bazë të nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka shqyrtuar vendimin e lartcekur dhe në konsultim me analisten e Buxhetit Komunal për këtë komunë, vlerëson se ky vendim është korrigjuar për një shumë të vogël të mjeteve, atëherë vetëm plotësimi i këtij vendimi mund të prodhojë efekte juridike.

Me respekt,